

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ARREDO DESIGN” SH.P.K.

Sot, më date **01/12/2022**, UNE, i nënshkruari:

- **Gentian KARAMETA** lindur ne Sheqeras, Korçë me 27/04/1975, shtetas Shqiptar, mbajtes i leternjoftimit ID H50427040D, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “**ARREDO DESIGN**” SH.P.K. (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: “**ARREDO DESIGN**” SH.P.K

Neni 2

(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën : Vlore Lagjja Kushtrimi, Rruga Dervish Hekali, Pasuria Nr.4/53-ND2, Zona Kadastrale 8605

(1.1) Shoqëria ka te drejte qe ta ndryshoje adresen e selise se saj, dhe te shtoje adresa te reja te ushtrimit te aktivitetit.

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: *arredodesign.vlore@gmail.com*
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë, dhe jashte saj.


Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat, per nje periudhe te pacaktuar kohore dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Neni 4

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm:



- Aktivitet ne fushen e tregtise , tregtimi me shumice dhe pakice i pajisjeve per bare, restaurante, piceri, pasticeri, xhelateri, furra buke, markete. Import te linjave teknologjike ushqimore, kryerja e sherbimeve te çdo lloji veçanarisht te atyre qe lidhen me organizimin ,furnizimin dhe administrimin e marketeve, bareve, restauranteve, hoteleve etj. Sherbime promovimi, reklamimi, marketingu dhe publiciteti dhe çdo aktivitet qe sherben per realizimin e qellimeve te mesiperme. Tregtimi me shumice dhe pakice i artikujve industrial, pajisjeve hidrosanitare, artikujve elektrike dhe elektroshtepiake, materialeve te ndertimit, pjese per automjete, artikujve te kopshtarise dhe orendite shtepiake, vegla pune dhe profesionale. Tregetimi me shumice dhe pakice I artikujve ushqimore dhe cdo gje qe perfshin gama e artikujve ushqimore. Import-Eksport i gjithe games se artikujve te mesiperm.. Shitje dhe prodhim I akullit. Aktivitet ne fushen e studimeve, projektimit dhe ndertimit, prodhimi dhe tregetimi i materialeve te ndertimit. Kompletim ne instalime, punime restaurimi, etj. Hapje e shkollave dhe kopshteve private. Prodhim dhe shitje asfalto-betonesh dhe nenproduktet e tyre.. Sherbime pastrimi, gjelberimi te zonave urbane. Administrimi dhe mbikqyrja e banesave sociale dhe te bonusit te strehimit. Agjensi Turistike, dhenie dhe marrje automjetesh me qera. Agjensi Imobiliare, studime tregu, komisioner dhe agjensi per te tretet. Aktivitet ne fushen e transportit : kryerja e transportit te mallrave per nevoja te veta dhe per llogari te te treteve

- Shoqeria mund te kryeje cfaredo lloj sherbimi qe paraqitet ne pajtueshmeri me objektin e saj dhe qe eshte lidhur me kete object.
- **Megjithate shoqeria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.**

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100.000** (njëqind mije) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Gentian KARAMETA**: Zotërues i 100% (njëqind përqind) te kuotave me vlerë të përgjithshme prej **100' 000** (njëqind mije) Leke që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para .

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Gentian Karameta


Shtimi ose pakesimi i kapitalit themeltar mund te behet vetem pasi Asambleja e ortakeve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithë ortaket jane te detyruar qe ta repektojne dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asamblese.

Neni 7 **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërise
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakeve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve, përse nuk parashikohet ndryshe në statur. Pjesët e kapitakit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

Neni 8 **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë.


Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përgjashtimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimmarres percaktohen ne statutin e shoqërise.

Neni 9 **Administrimi**

Aministratori i shoqërise emerohet **Z. Gentian KARAMETA** lindur ne Sheqeras, Korçë me 27/04/1975, shtetas shqiptar , mbajtes i leternjoftimit ID H50427040D , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar., i zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqërise.



Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Modalitetet për prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë të percaktuara në statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i Ndryshuar.

Neni 12

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale.

ORTAKËT E SHOQËRISË

Gentian KARAMETA

Gentian Karameta
